

Rregullore e Konkursit Ndërkombëtar të Fotografisë **“Ngjyrat e Orthodhoksisë. Shqipëria”**

1. Organizatorët

Konkursi organizohet nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, OrthPhoto.net dhe Departamenti i Botimeve i Kishës Orthodhokse të Polonisë.

2. Media Partner

Radio Televizioni Shqiptar, Radio “Ngjallja”, gazeta “Koha Jonë”

3. Kohëzgjatja

Konkursi fillon më 10/04/2019 dhe përfundon më 31/08/2019

4. Qëllimet dhe objektivat

Konkursi organizohet për të paraqitur diversitetin dhe bukurinë e Orthodhoksisë në Shqipëri. Përmes konkursit, që do të kulmojë me botimin e një albumi dhe çeljen e një ekspozite, dëshirojmë t'i paraqesim publikut të gjerë jetën e krishterë në Shqipëri. Fotografitë e kërkuara duhet të jenë pjesë e këtyre kategorive: **1. Kisha** (arkitekturë, afreske, kryqe, kisha në natyrë, peizazhe, etj.). **2. Njerëz** (klerikë dhe laikë, portrete, etj.). **3. Reportazhe** (ngjarje kishtare, pelegrinazhe, të kremte fetare). **4. Ringjallja e Kishës** (Gjatë dekadave të fundit të shek. XX, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë u gjend në një pozitë të veçantë kishtare, rast unik, dhe, për pasojë, në qendër të vëmendjes në mbarë botën. Nga viti 1967 deri në vitin 1990, njerëzit besonin se Kisha në Shqipëri ishte shuar plotësisht nga presioni i egër i shtetit ateist dhe se ajo tashmë i përkiste së shkuarës. E megjithatë, nga viti 1991 e në vazhdim, ajo përjetoi ringritjen nga gërmadhat dhe gëzon një lulëzim në mbarë shprehjet e jetës së saj. Kjo kategori fotografike synon të pasqyrojë njëzet e shtatë vjet të "Ringjalljes" së Kishës Orthodhokse në Shqipëri dhe të nxjerrë në pah aspekte të ndryshme të jetës së saj (vepra ndërtuese, kleri, rinia orthodhokse, shëndetësia, arsimi, kontributi për kulturën, vepra sociale dhe humanitare etj.) përmes fotografive ekspresive, të cilat shpesh dëshmojnë shumë më tepër, siç thotë edhe shprehja kineze "një foto vlen sa një mijë fjalë".

5. Kushtet e pjesëmarrjes / Të drejtat e autorit

Pjesëmarrja në konkurs është pa pagesë.

5.1 Konkurruesit duhet të dërgojnë fotografitë e tyre gjatë periudhës mes datave 10/04/2019 dhe 31/08/2019.

5.2 Konkurruesit mund të dorëzojnë deri në 6 fotografi për secilën kategori.

5.3 Fotografitë duhet të dërgohen së bashku me titullin, të dhënat e autorit (emrin, adresën dhe numrin e telefonit), datën dhe vendndodhjen e fotografisë (nëse është e mundur lidhja me koordinimin e Google Maps ose GPS) në adresën elektronike: competition@orthphoto.net.

5.4 Cilësia dhe madhësia e fotografisë duhet të jenë jo më pak se 2000 pixels në të dyja përmasat, gjerësi ose lartësi. (Është mirë të dërgohet skedari origjinal.) Madhësia maksimale e skedarit të fotografisë është 18Mb.

5.5 Konkurruesi duhet të jetë autori i fotografive, të zotërojë dhe të jetë në gjendje të faktojë se zotëron të gjitha të drejtat për fotografitë e dorëzuara. Konkurruesit që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale ose lejen e një personi tjetër, nuk mund të marrin pjesë në konkurs.

Fotografitë nuk mund të kenë përmbajtje mashtruese, kërcënuese, të rreme, joshëse, abuzive, ngacmuese, shpifëse, vulgare, të turpshme, skandaloze ose zjarrndezëse.

5.6 Regjistrimi në konkurs nuk transferon pronësinë e të drejtave për fotografitë e paraqitura, por përbën dhënie të lejes ndaj organizatorëve dhe partnerëve, siç përshkruhet më poshtë.

Me pjesëmarrjen e tyre në konkurs, konkurrentët i japin organizatorëve (OrthPhoto.net, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë dhe Kisha Orthodhokse e Polonisë) të drejtën dhe lejen për t'i publikuar fotografitë në botimet e tyre (albume, kalendarë, ekspozita). Çdo përdorim tjetër i fotografive kërkon lejen e konkurruesve. Nëse fotografitë e konkurruesve do të përdoren nga organizatorët ose partnerët e tyre, konkurruesit do të marrin informacion për këtë me të paktën një kopje të publikimit të shtypur.

5.7 Vendimet e jurisë së konkursit janë përfundimtare dhe të përvokueshme. Nuk do të ketë korrespondencë në lidhje me vendimet e jurisë.

5.8 Me pjesëmarrjen në këtë konkurs, konkurrentët bien dakord me këto rregulla dhe pranojnë të jetë të kushtëzuar prej tyre.

5.9 Pjesëmarrësit në konkurs japin lejen për transferimin e të dhënave të tyre personale tek organizatorët për qëllime të konkursit (në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale).

6. Komisioni i Jurisë

Juria për këtë konkurs është ndërkombëtare dhe përbëhet nga 5-7 persona.

7. Çmimet

Për këtë konkurs do të shpërndahen çmimet e mëposhtme:

- Grand Prix: 600 Euro
- Çmimi i parë për çdo kategori: 200 Euro
- Çmimi i dytë për çdo kategori: 100 Euro
- Çmimi i tretë për çdo kategori: 50 Euro
- Vlerësim nderi: Një album fotografik nga botimet e partnerëve tanë. (Numri i vlerësimeve të nderit do të vendoset nga juria).

Të gjitha shpërblimet financiare të çmimeve do të jepen me çeqe që do të lëshohen nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve ose do të dërgohen te fituesit në adresën e dhënë.

Fituesit janë përgjegjës për raportimin e të ardhurave tek autoritetet siç kërkohet me ligj dhe për pagimin e çfarëdo takse që ata mund të jenë të detyruar për çdo çmim.